



## **VENDIM MBI PRANUESHMËRINË**

**Data e miratimit: 11 shtator 2019**

**Nr. i lëndës: 2016-12**

**U.F.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, i mbledhur më 11 shtator 2019, me përbërjen si në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare  
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. Ron HOOGHMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës për rastin e lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e Llogaridhënies së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe Rregulloren së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 15 janar 2019,

Vendosi si vijon:

### **I. PROCEDURA PARA PANELIT**

1. Ankesa për këtë rast është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Me letrën e datës 1 korrik 2016, Paneli informoi Misionin për regjistrimin e këtij rasti.
3. Më 28 qershor 2017 Paneli i kërkoi këtij ankuesi dhe ankuesve të tjerë që të japin informata shtesë lidhur me ankesat e tyre.

4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017 Paneli i dërgoi përfaqësuesit të ankuesit edhe dy kërkesa për informata shtesë.
5. Më 20 tetor 2017 Paneli pranoi një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesit me informata shtesë lidhur me dy raste, përfshirë për rastin në fjalë.
6. Më 8 dhjetor 2017 Paneli ia dërgoi Shefes së Misionit (SHM) EULEX Kosova Deklaratën e fakteve dhe pyetjeve, dhe e ftoi atë të japë përgjigje dhe vërejtje me shkrim në lidhje me ankesat më së largu deri më 26 janar 2018.
7. Përmes letrës së datës 17 janar 2019, Misionit iu kërkua prapë që të japë përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
8. Përmes letrës së datës 8 prill 2019, Misionit iu kërkua që të japë informata se kur do të mund t'i jepte përgjigjet ndaj pyetjeve, dhe prapë iu kërkua që të përgjigjej sa më parë që ishte e mundur.
9. Vërejtjet nga SHM u pranuan më 14 qershor 2019, dhe ato u komunikuan tek ankuesit për vërejtje shtesë.
10. Më 5 korrik 2019 ankuesi parashtroi vërejtje shtesë, të cilat u dërguan tek SHM për informim.

## **II. QËNDRIMI DHE IDENTITETI I ANKUESIT**

11. Duke pasur parasysh lidhjen familjare të afërt mes viktimës kryesore, pra vëlla, Paneli pranon që ankuesi të konsiderohet si viktimë dytësore i shkeljeve të pretenduara dhe se, si i tillë, viktimë potenciale në pajtim me Rregullën 25(1) të procedurës së punës së Panelit.
12. Ankuesi në rastin 2016-12 ka kërkuar që identiteti i tij të mos shpaloset. Pas shqyrtimit të çështjes, në veçanti natyrës së pretendimit të bërë, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli") pranoi që kërkesa të miratohej.

## **III. FAKTET**

13. Faktet e këtij rasti, ashtu siç janë të prezantuara në ankesë, mund të përmbliidhen si në vijim.
14. Më 9 mars 2000 u bë kidnapimi i vëllait të ankuesit. Për herë të fundit atë e kishte parë dhëndri i tij diku rreth orës 10.15 në shtëpinë e familjes së tij në pjesën veriore të Mitrovicës.
15. Po ashtu ka pretendime se ai ishte parë edhe në një shtëpi tjetër të familjes në Vushtri rreth po të njëjtës kohë "ku nga anëtarë të një shërbimi të sigurisë ai ishte futur me dhunë në një veturë të tipit Golf 2 me ngjyrë të zezë. Që atëherë më nuk është parë.

16. Për zhdukjen e tij janë lajmëruar Policia e UNMIK-ut në pjesën veriore të Mitrovicës, KFOR-i dhe pastaj EULEX Kosova. Ankuesi po ashtu thekson se për zhdukjen e tij ishin informuar edhe 'organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare që merren me të drejtat dhe liritë e njeriut'. Prej parashtrësive pasuese duket se ankuesi nuk ka kontaktuar drejtpërdrejtë EULEX-in, por supozon se informatat e dhëna tek institucionet e tjera do të ishin përcjellë tek EULEX-i (shih, para. 33, *më poshtë*). Sa i përket EULEX-it, në veçanti, ankuesi ka pohuar para Panelit se në një datë të pacaktuar, në kohën kur EULEX-i sapo kishte ardhur në Kosovë, gjatë një takimi të Shoqatës serbe për personat e zhdukur ai kishte biseduar me një pjesëtar të stafit të EULEX-it për familjarin e tij të zhdukur.

#### IV. ANKESA

17. Ankuesi i referohet një sërë dispozitash të traktateve dhe garantimeve të ndërlidhura, të cilat ai thotë se janë shkelur nga Misioni:
- i. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, nenet 1, 2, 3, 7 dhe 13;
  - ii. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej në tekst 'Konventa'), nenet 2, 5, dhe 15; dhe
  - iii. Protokollin 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 2.
18. Në nenet 1, 2 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut përcaktohet trajtimi i barabartë dhe ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit. Në nenin 3 përcaktohet se çdo person ka të drejtë për jetë, liri, dhe siguri, ndërsa në nenin 13 garantohet e drejta e çdo personi për liri dhe lëvizje. Në nenin 2 të Konventës Evropiane përcaktohet mbrojtja e të drejtës për jetë, ndërsa në nenin 5 përcaktohet garantimi i të drejtës për liri dhe siguri dhe në nenin 15 përcaktohet derogimi i të drejtave në periudha të emergjencave. Në nenin 2 të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut prapë përcaktohet mbrojtja kundër diskriminimit.
19. Përveç kësaj, në përputhje me praktikën e mëparshme të tij, Paneli ka marrë në konsideratë nenet potencialisht relevante 8 dhe 13 të Konventës.
20. Për arsyet e dhëna më poshtë, Paneli ka marrë qëndrim se ky rast duhet të shpallet i pranueshëm në lidhje me shkeljet e pretenduara të këtyre dispozitave: nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (dhe garancitë e barasvlershme të përcaktuara në instrumentet e tjera ndërkombëtare të aplikueshme). Ankesa është shpallur e papranueshme sa i përket pjesëve të tjera.

#### V. PARASHTRËSAT E PALËVE

##### Ankuesi

21. Siç është përmbledhur më lartë, ankuesi pretendon se gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv EULEX Kosova duhej ta kishte hetuar zhdukjen e vëllait të tij, dhe se në

mënyrë të dënueshme nuk ka vepruar ashtu, duke i shkelur të drejtat themelore të vëllait të tij.

### **Shefi i Misionit (“SHM”)**

22. Parashtrësasat e Misionit në lidhje me pranueshmërinë e këtij rasti janë pranuar në Panel më 14 qershor 2019.
23. Sipas atyre parashtrësave, në kuadër të dorëzimit të rasteve dhe dosjeve nga UNMIK-u tek EULEX-i në periudhën dhjetor 2008 – mars 2009, stafi i Misionit në atë që sot njihet si Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) mori një bazë të dhënave që përmbante formularët e identifikimit të viktimave për personat e raportuar si të zhdukur gjatë dhe pas konfliktit. Ajo bazë e të dhënave ka përmbajtur një ‘formular të identifikimit të viktimës’ për familjarin e ankuesit. Në atë formular ceket se familjari i ankuesit (më tej në tekst: ‘i zhdukuri’) ishte parë për herë të fundit në Vushtrri më 9 mars 2000. Aty nuk ka informata lidhur me rrethanat e asaj zhdukjeje.
24. Në një bazë tjetër të dhënave e dorëzuar në EULEX nga UNMIK-u shihet se, siç duket në vitin 2003, asaj zhdukjeje i ishte caktuar një numër rasti në Njësinë e Policisë së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur (NJPZh). Megjithatë, Misioni nuk ka marrë dokumente të NJPZh në lidhje me të.
25. I vetmi dokument tjetër që EULEX ka marrë nga dorëzimi i rasteve nga UNMIK e që ka të bëjë në mënyrë specifike me këtë zhdukjeje është një kërkesë e panënshkruar e datës 18 dhjetor 2001 e parashtruar nga një avokat [siç supozohet në emër të familjes së të zhdukurit] e cila i drejtohej Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ku kërkohej zgjerimi i një hetimi në proces e sipër kundër disa të dyshuarve me qëllim përfshirjen e hetimit për një kidnapim të pretenduar të zhdukurit dhe personave të tjerë.
26. Misioni më tej parashtron se Misioni nuk ka të dhëna që ankuesi i ka njoftuar njësitë policore dhe prokuroriale të Misionit në lidhje me zhdukjen e vëllait të tij. Misioni po ashtu pohon se, sipas të dhënave që i ka, nuk ka pasur përfshirje të Misionit në lidhje me zhdukjen e familjarit të ankuesit.
27. Si përgjigje ndaj pyetjes së Panelit për atë pikë, Misioni ka dhënë një shpjegim të gjerë të procesit të ndërlikuar të marrjes, regjistrimit, kategorizimit, ruajtjes dhe rishikimit të dosjeve të pranuar nga UNMIK-u. Misioni në atë kontekst i drejtohet vështirësive të përfshira dhe sfidës nga aspekti praktik dhe logjistik. Efekti dhe pasojat e disa prej fakteve të përkufizuara në këtë kontekst do të konsiderohen nga Paneli në fazën e meritës aty ku është relevante.
28. Misioni po ashtu specifikon se Misioni nuk është në dijeni rreth ndonjë hetimi në proces e sipër të zhvilluar nga autoritetet e Kosovës për këtë rast dhe ‘e fton ankuesin që këtë pyetje ta drejtojë te institucionet kompetente të Kosovës’.
29. Në fund, në lidhje me pyetjen e përputhshmërisë së Misionit me detyrimet e tij për të drejtat e njeriut, Misioni së pari i drejtohet praktikës gjyqësore dhe parimeve që dalin nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me ‘përshejtimin

e arsyeshëm' që pritet prej ankuesve sa i përket parashtrimit të ankesave në rastet e pretendimeve për shkelje në vazhdim e sipër të drejtave të njeriut. Për zbatimin e atyre standardeve për rastin aktual, Misioni parashtron se ankuesi (apo familjarët e tjerë) asnjëherë nuk e kanë kontaktuar Misionin, dhe parashtron se vonesa për parashtrimin e ankesës para Panelit (17 vite që nga zhdukja) është 'ekstreme' dhe 'e pashpjeguar'. Mbi atë bazë, Misioni parashtron se ankesa duhet të shpallet e papranueshme *ratione temporis*.

30. Më 21 gusht 2019, Paneli ka kërkuar sqarim nga Misioni nëse ndonjë dosje lidhur me këtë rast i është bartur autoriteteve vendore të Kosovës në kohën e tranzicionit të Misionit në qershor 2018.

31. Përmes një e-maili të datës 23 gusht 2019, Misioni sqaroi çështjen si në vijim:

“Formuari i identifikimit të viktimës për familjarin e U.F., si të gjithë ‘formularët e tjerë të identifikimit të viktimave’, ka qenë i qasshëm për autoritetet e vendit që nga fillimi i mandatit të EULEX-it. Sa i përket kërkesës së avokatit të cekur në faqen 2 të përgjigjeve nga EULEX-i të datës 14 qershor 2019, ai dokument i është bartur autoriteteve të vendit si pjesë e procesit të dorëzimit që është përmbyllur më 14 dhjetor 2018. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se EULEX Kosova nuk e ka pranuar dokumentin në origjinal nga UNMIK-u por vetëm kopje të tij; Misioni nuk është në dijeni për vendndodhjen e dokumentit origjinal.”

### **Përgjigja e ankuesit**

32. Më 5 korrik 2019 ankuesi bëri parashtrësja shtesë, të cilat u përcollën te Misioni për informim.

33. Në ato parashtrësja, ankuesi në veçanti ka kundërshtuar parashtrësën e Misionit se Misioni nuk ka qenë i informuar për çështjen. Në veçanti, ankuesi potencon faktin se ‘një raportim rreth një personi të zhdukur në territorin e Kosovës dhe Metohisë pas situatës pas konfliktit ka kërkuar urgjencë dhe efikasitet në veprimet e organeve të autorizuar, meqë çdo vonesë mund të kishte ndikim tek rezultatet e hetimeve’. Ankuesi shton se nëse Misioni nuk ka bërë regjistrimin dhe organizimin e regjistrave të veta në mënyrën e duhur, të tjerët nuk duhet të fajësohen për atë dështim dhe ai dështim nuk duhet të ndikojë tek meritat e ankesës së tij.

34. Më tej, ankuesi thekson se nuk ka informata në lidhje me materialin që UNMIK-u ka përcjellë tek EULEX-i, meqë asnjëra prej këtyre organizatave nuk e ka kontaktuar atë asnjëherë.

35. Ankuesi po ashtu thotë se përgjegjësia e Misionit për të zhvilluar hetime në asnjë mënyrë nuk mund të diktohet nga mënyra në të cilën UNMIK-u i ka emërtuar apo organizuar dosjet, dhe se ajo nuk mund të ndikojë te detyrimet e tij për të drejtat e njeriut:

“Nga momenti që ato dosje të rasteve i janë dorëzuar, Misioni ka qenë përgjegjës për shqyrtimin dhe hetimin efikas të tyre.”

36. Ankuesi nuk ka informata lidhur me hapat e ndërmarrë nga Misioni për hetimin e këtij rasti, nëse ka pasur ndonjë hap që është ndërmarrë. As bashkëpunimi i familjarëve nuk është kërkuar dhe ankuesi nuk është në dijeni për ndonjë përpjekje të bërë për hetimin e këtij rasti. Familjes nuk i është dhënë asnjë dokument në lidhje me rastin. Ankuesi shton si në vazhdim:

“Fakti se autoritetet, kompetente për zhvillimin e hetimeve për zhdukjen e [edituar], vazhdimisht janë ndërruar njëra pas tjetrës, në asnjë mënyrë nuk mund të jetë arsytim për sjellje pasive/mosveprim nga ana e autoriteteve, e as t’i vihet barrë familjes së personit të zhdukur. Autoritetet kanë qenë përgjegjëse për të vepruar në lidhje me personin e raportuar si të zhdukur, për të bërë kërkime dhe hetime për atë rast, për të kryer hetime të duhura, për ta përfshirë familjen në procedura dhe për të raportuar rreth veprimeve të ndërmarra. Kjo në rastin tonë, përsërisim, nuk është bërë asnjëherë.”

37. Si përgjigje ndaj parashtresës së Misionit se ankuesi nuk i ka paraqitur argumentet juridike në lidhje me përgjegjësinë, ankuesi thekson si në vazhdim:

“Ajo që familja [edituar nga Paneli] pret është gjetja e [viktimës – edituar nga Paneli] që u zhduk në rrethana kërcënuese për jetën, gjë që familja ia kishte besuar autoriteteve kompetente. Megjithatë, arsytimi që ankesa “**përfshinë vetëm numra të neneve që pretendohet se janë shkelur dhe**” tregon se si Misioni e konsideron Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe familjen e viktimës. Po ashtu, në çfarë baze konkludon se ato nene dhe instrumentet ndërkombëtare relevante “**pretendohet**” se janë shkelur, nëse familja nuk e di nëse janë zhvilluar hetime.

Sa i përket referimit të rastit *Varnava et al kundër Turqisë* para Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe renditja e argumenteve të pabazuara që i referohen vendimit të përmendur, ne duhet të themi se interpretimi i këtij vendimi është absolutisht i pavlefshëm për rastin nr. 2016-12, UE kundër EULEX-it.

Së pari, të drejtat të cilave ankuesi i është referuar janë në mesin e parimeve, të drejtave dhe lirive themelore, të parapara dhe të garantuara me konventën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Së dyti, prokurorët e EULEX-it janë të mandatuar që të hetojnë shkeljet e të drejtave të referuara nga ankuesi pavarësisht veprimeve të ankuesve, apo të referuara nga ta si “vonesë e panevojshme”. Së treti, një hetim gjithëpërfshirës dhe efektiv është i rëndësishëm për krijimin e ndjenjës së llogaridhënies dhe të kujdesit për sundimin e ligjit në çdo shoqëri që është në situatë pas ndonjë konflikti, sepse përgjegjësia duhet të jetë e të gjithëve, jo vetëm e atyre të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Jua përkujtoj se ky rast ka të bëjë me një person të përkatësisë kombëtare serbe, i zhdukur në rrethana kërcënuese për jetën në një mjedis etnikisht të pastër, i banuar pas luftës nga shqiptarë, dhe se ne dyshojmë se ai është vrarë, se familja i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sa i përket raportimit të zhdukurit tek autoritetet kompetente, se familja asnjëherë nuk është përfshirë në procedurat para hetimore/hetimore nga ana e autoriteteve, dhe se familja dyshon që rasti asnjëherë nuk është hetuar në mënyrë efektive. Nuk është e duhur që në mungesë

të çdo informate nga UNMIK-u dhe EULEX-i t'i vihet viktimës dhe familjes së viktimës nocioni i "vonesës së panevojshme", duke pasur parasysh se familja asnjëherë nuk është informuar rreth rezultateve të hetimeve, andaj në rastin specifik ne nuk mund të flasim për "mosinteresim", duke pasur parasysh se zhdukja e personit është raportuar tek të gjitha institucionet, ankesa është dorëzuar në qershor 2016, kur familja është informuar tek në vitin 2016 se hetimet nuk janë kryer në mënyrë efektive (*shih Brunner kundër Turqisë* (Vendimi nr. 10/10; *Varnava et al kundër Turqisë* (GC), si më lartë, §157).

Theksojmë se familja [*e edituar nga Paneli*] nuk ka pasur për qëllim ta paraqesë rastin në gjykatën në Strasburg, por ka pritur që hetimet do të kryheshin, se [*viktima – e edituar nga Paneli*] do të gjendej i gjallë apo i vdekur, se ajo do të mësonte se si ishte vrarë, kush e kishte vrarë, dhe do të mësonte për vendndodhjen e tij [*mbetjeve mortore të tij*], dhe jo raportin mes UNMIK-ut dhe EULEX-it me rastin e dorëzimit të përgjegjësive, apo raportin e këtyre organeve me Policinë e Kosovës, apo "respektin e tyre për dhimbjen e ankuesit dhe familjarëve të tij".

## VI. VLERËSIMI I PANELIT

### *Mandati i Panelit (rregulla 25 par. 1 i rregullores së punës)*

38. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet për të drejtat e njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
39. Para shqyrtimit të ankesës sa i përket meritave të saj, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të vazhdojë me ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë së përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës.
40. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX Kosova gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.
41. Paneli tashmë ka vendosur në rastet e kaluara që ankesat si kjo e tanishmja në parim janë në suaza të fushëveprimit të kompetencave të tij. Nuk ekziston ndonjë arsye bindëse për t'u shmangur nga ky qëndrim në lidhje me këtë ankesë. Në këtë kontekst, Paneli duhet të ri-përsërisë se hetimi i rasteve të 'zhdukjeve të detyruara' jo vetëm që përbënte pjesë të mandatit të këtij Misioni, por edhe ishte element thelbësor dhe esencial i tij. Në rastin L.O. kundër EULEX-it, Paneli ka nënvizuar se 'nuk ka asnjë dyshim se hetimi i fatit të zhdukurve, pa dallim feje apo etnie, duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operacional për EULEX-in si Misioni i Sundimit të Ligjit për të cilën ai

duhet të pajiset me burime të mjaftueshme' (L.O. kundër EULEX-it, rasti Nr. 2014-32, Vendimi dhe konstatimet, 11 nëntor 2015, paragrafi 47).

*Përputhshmëria me rregullën e 6 muajve dhe kompetenca racione temporis*

42. Siç u diskutua më sipër (shih, *supra*, para. 29), Misioni i ka tërhequr vëmendjen Panelit te praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me parimin e shpejtësisë të arsyeshme në lidhje me paraqitjen e ankesës, dhe ka parashtuar se mbi këtë bazë kjo ankesë nuk i plotësonte këto standarde dhe duhej të shpallej e papranueshme.
43. Si çështje preliminare, Paneli duhet të theksojë se kushtet e pranueshmërisë janë përcaktuar në Rregulloren e punës së tij. Lidhur me afatin kohor, Rregullorja i parasheh kushtet e mëposhtme (Rregulla 25, paragrafët 2-4):
  2. Paneli i shqyrton vetëm ankesat që kanë të bëjnë për shkelje të pretenduara të drejtave të njeriut, të cilat kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2008 në Kosovë.
  3. Ankesat duhet të dorëzohen te Paneli brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar.
  4. Pavarësisht nga paragrafi 3, ankesat lidhur me lëndët e transferuara nga EULEX-i te institucionet e Kosovës duhet të parashtrohen brenda gjashtë muajve nga përfundimi i mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale, siç përcaktohet në ligjin e Kosovës ose brenda gjashtë muajve nga transferimi i dosjes së lëndës.
44. Mbi këtë bazë, '[a]nkesat duhet të dorëzohen te Paneli brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar. Shih, p.sh., *Gashi v EULEX*, 2013-22, 7 prill 2014, paragrafi 10; *Thaqi v EULEX*, 2010-02, 14 shtator 2009, paragrafi 51.
45. Gjatë aplikimit të këtyre dispozitave, Paneli ka konstatuar se nëse shkelja e të drejtave themelore është e vazhdueshme, afati gjashtëmuajor nuk ka skaduar në parim deri sa të pushojë shkelja. Shih, p.sh., *Zahiti kundër EULEX-it*, 7 qershor 2013, paragrafi 42. Në këtë rast, afati fillon të rrjedhë në datën pas veprimit të kundërshtuar i cili thuhet se e ka shkaktuar ose ka rezultuar në shkeljen e të drejtës. Shih, p.sh., *Y kundër EULEX-it*, 15 nëntor 2012, paragrafët 30-31. Në këtë rast, shkelja e pretenduar ishte e vazhdueshme dhe ka vijuar deri në qershor 2018 kur mandati i këtij Misioni u ndryshua dhe ai e humbi mundësinë për t'i hetuar (apo të vazhdojë t'i hetojë) këto raste.
46. Përveç kriterëve të sipërpërmendura, Rregullorja nuk e përcakton ndonjë kriter tjetër për kohën apo 'shpejtësinë e arsyeshme' që do ta rregullonte ose kushtëzonte pranueshmërinë e ndonjë ankese përpara Panelit. Kjo arsye është e mjaftueshme që Paneli ta hedh poshtë argumentin e Misionit si jorelevant dhe autoritetet e cituara si të paaplikueshme në këto procedura. Në të vërtetë do të ishte e padrejtë që një rast të shpallet i papranueshëm në bazë të një kriteri i cili nuk është pjesë e kornizës normative të këtij Paneli.



47. Megjithatë, siç është pranuar në rastin 2017-02, parimi i 'shpejtësisë së arsyeshme' i aplikuar përpara GJEDNJ-së në përgjithësi mëton ta ruajë efektivitetin e të drejtave të ndonjë ankuesi derisa në të njëjtën kohë i shmangë vonesat e panevojshme të cilat mund të ndikojnë në atë qëllim dhe krijojnë një gjendje të pasigurisë së përhershme ligjore. Shih Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafi 50. Ky është një qëllim të cilin Paneli gjithashtu e ka në mendje që ta ruajë në kontekstin e mandatit të tij derisa ka parasysh specifikat e këtij mandati, të diskutuara më poshtë. Shih gjithashtu D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, Rasti Nr. 2014-11, 2014-12, 2014-13, 2014-14, 2014-15, 2014-16, dhe 2014-17, 30 shtator 2015, paragrafët 94-97; Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it, Rasti Nr. 2014-34, 29 shtator 2015, paragrafët 43-48; Dragiša Kostić kundër EULEX-it, Rasti Nr. 2016-10, 19 qershor 2019, paragrafët 37-45.
48. Me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështjeje, Paneli konstaton si në vijim. Së pari, nëse parashtruesit e ankuesit pranohen, shkelja e pretenduar e të drejtave të tij do kishte qenë në vazhdimësi përgjatë gjithë kohës relevante deri në qershor 2018, d.m.th., edhe *passi ai* e kishte parashtruar ankesën e tij në Panel.
49. Së dyti, kompetenca dhe përgjegjësia e Misionit për hetimin e këtij lloji të rasteve ka ekzistuar, *proprio motu*, si çështje e ligjit. Ajo nuk është varur dhe nuk është kushtëzuar nga ajo nëse të afërmit e të zhdukurit e kanë kërkuar këtë formalisht apo nëse e kanë kontaktuar Misionin për këtë. Në këtë rast si ky i tanishmi, EULEX-i është në fakt përgjegjës për të vepruar *proprio motu* me qëllim të sigurimit që zhdukja të hetohet me kujdes, menjëherë, dhe në mënyrë efektive. Shih, p.sh., L.O. kundër EULEX, 2014-32, Vendimi dhe konstatimet, 11 nëntor 2015, paragrafi 63, dhe referencat e tij në GJEDNJ: Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë, Padia nr. 21689/93, Aktgjykimi i datës 6 prill 2004, paragrafi 310; Isayeva kundër Rosisë, Padia nr. 57950/00, Aktgjykimi i datës 24 shkurt 2005, paragrafi 210. Shih gjithashtu, në përgjithësi, Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimi dhe konstatimet, 19 tetor 2016, paragrafi 41; L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe konstatimet, 11 nëntor 2015, paragrafi 63; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 29 shtator 2015, paragrafi 46 ("kompetenca e prokurorëve të EULEX-it për të hetuar shkeljet e pohuara të këtyre të drejtave është e pavarur prej ndonjë ankese të paraqitur nga viktimat apo prej të afërmeve të tyre, pra ka pasur një pritje ligjrisht të bazuar se ata do ta shqyrtonin këtë rast, pavarësisht nga veprimet e ankueses."); D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim për pranueshmëri, 30 shtator 2015, paragrafi 97.
50. Prandaj, Misioni do të kishte pasur për obligim për të hetuar prej momentit kur është njoftuar për ekzistimin e këtij rasti (d.m.th., fundi i 2008 – fillimi i 2009). Dhe, sipas regjimit të aplikueshëm, ai do të kishte qenë kompetent për ta filluar një hetim *proprio motu* deri në maj/qershor 2014 dhe, pas asaj kohe, sipas klauzolës "rrethana të jashtëzakonshme" të Ligjit të rishikuar për Kompetencat. Andaj, në rastin *Sadiku-Syla*, Paneli ka thënë si vijon:

"[S]HM pohon se legjislacioni i ri që ka hyrë në fuqi me 17 maj 2014 e ka "ulur ndjeshëm mundësinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it për të ushtruar funksione ekzekutive në lëndë të reja" (Përgjigje, fq. 6, duke iu referuar Ligjit omnibus që e ka ndryshuar Ligjin për Kompetencat). Megjithatë Paneli vëren se

neni 7(A) parasheh "Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme": "Në rrethana të jashtëzakonshme një lëndë do t'i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët nga Kryeprokurori i shtetit dhe autoriteti kompetent i EULEX KOSOVA. "SHM nuk ka arritur të shpjegojë pse kjo dispozitë nuk ofron bazë ligjore të duhur mbi të cilën prokurorët e EULEX-it duhet të veprojnë, në mënyrë të veçantë në një rast siç është rasti në fjalë, ku autoritetet vendase nuk duket se janë duke bërë hetime. Paneli i fton palët që ta adresojnë këtë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashtresa shtesë në lidhje me meritat e kësaj lënde."

Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 29 shtator 2015, paragrafi 62. Shih edhe, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, paragrafi 90; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, paragrafët 23 et seq.

51. Për më shumë, Paneli konstaton se në bazë të OPLAN-it të rishikuar, siç është pasqyruar në Rregullën 25(4) të Rregullores së Punës të Panelit, ankesat lidhur me rastet e transferuara nga EULEX-i te institucionet e Kosovës duhet të parashtrohen brenda gjashtë muajve prej përfundimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale, e përkufizuar në ligjin e Kosovës, apo brenda gjashtë muajve prej transferimit të dosjeve të lëndës. Duke e pasur parasysh se transferimi i këtij rasti ka përfunduar në dhjetor të vitit 2018, afati për parashtrimin e ankesës nuk kishte skaduar ende në kohën e parashtrimit të kësaj ankese.
52. Së treti, nga parashtresat e Misionit duket sikur ky rast i është përcjellë këtij Misioni si një rast 'i hapur' ose 'në vijim' nga UNMIK-u pasi që nuk ishin gjetur asnjë nga mbetjet mortore të zhdukurit dhe se nuk ishte marrë asnjë vendim formal për ta mbyllur atë. Me fjalë tjera, ky rast ishte në dosjet e UNMIK-ut dhe pastaj në dosjet e Misionit, megjithëse kishte mbetur joaktiv për gati dy dekada.
53. Së katërti, nga parashtresat e tij është e dukshme që ky Mision nuk ndërmori asnjë hap për t'i kontaktuar apo intervistuar të afërmit e të zhdukurit; si dhe nuk i ka ofruar këtyre të afërmeve asnjë informacion që e kishte në posedim. Në këto rrethana, është e paqartë nëse të afërmit e të zhdukurit e kanë marrë vesh ndonjëherë se ky Mision kishte në posedim të tij informata përkitazi me zhdukjen e tij. Në fakt, nga parashtresat e ankuesit duket se ata kishin mësuar këtë nga parashtresat e SHM për këtë rast.
54. Së pesti, për vlerësimin e sjelljes së ankuesit në këtë rast, duhet të merren parasysh një numër i faktorëve:
  - i. Një prej tyre të bëjë me natyrën e veprimeve në fjalë. Në një rast të kësaj natyre, '[d]uhet të lihen mundësi për pasigurinë dhe konfuzionin që shpesh krijohen nga pasojat e zhdukjeve. Shih *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* paragrafët 162-163; dhe Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafi 51. Paneli pajtohet. Gjykata më pas thotë se 'natyra e rëndë e zhdukjeve është e atillë që standardi i shpejtësisë që pritet nga të afërmit nuk mund të jetë shumë i rreptë në kontekstin e mbrojtjes së Konventës'. Shih

*Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* paragrafët 162-163; dhe Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafi 51.

- ii. Po ashtu duhet shqyrtuar faktin që një numër i institucioneve ishin përgjegjëse njëra pas tjetrës për të 'bërë diçka lidhur me' këtë rast: UNMIK-u, EULEX Kosova, dhe tani autoritetet vendase. Edhe institucione tjera kanë luajtur një rol në lidhje me rastet e zhdukjeve të detyruara, përfshirë KNKK-në. Ankuesi dhe të afërmit e tij në këtë rast e kanë raportuar këtë rast në disa prej këtyre organizatave (shih, *supra*, paragrafi 16). Në këtë kuptim, ato vështirë se mund të thuhet që ishin joaktive. Përkundrazi, asnjë prej këtyre institucioneve në dukje nuk ka kryer ndonjë hetim të këtij rasti. Për më tepër, siç shihet nga parashtresat e ankuesit të datës 5 korrik 2019, ai me të vërtetë mund të ishte hutuar nga radhët e autoriteteve nga të cilat pritej të hetonin këtë rast. Dhe mbase nuk ishte plotësisht e paarsyeshme nga ana e tij që të supozonte se, duke e njoftuar organizatën përgjegjëse për të hetuar rastin në kohën më të afërt me zhdukjen (d.m.th. UNMIK-un) nuk ishte e domosdoshme përsëri që të kontaktonte edhe një herë organizatën që i mori përsipër rastet nga ai (d.m.th. EULEX Kosova).
  - iii. Një specifikë tjetër e rëndësishme që e karakterizon punën e këtij Misioni dhe llogaritjen e kohës për të paraqitur ankesë para Panelit është fakti që ky Mision u krijua një dekadë pas ngjarjeve përkatëse. Pas kësaj kohe, u deshën vite të tjera që Misioni ta fillojë hetimin e rasteve të llojit që janë duke u shqyrtuar tani. Në këtë kuptim, përpara se një ankues madje mund të mendonte të paraqiste një ankesë në Panel duke pretenduar një dështim nga ana e këtij Misioni, më shumë se një dekadë do të kishte kaluar tashmë. Kjo situatë e veçantë duhet domosdoshmërisht të merret parasysh kur vendoset nëse ndonjë ankues ka vepruar në kohën e duhur kur ankohet për mos veprim nga ana e Misionit.
  - iv. Gjithashtu, në kontekstin aktual, është i rëndësishëm fakti që, si viktimi të përkatësisë etnike serbe, të paktën për ca kohë do të ishte e ndërlikuar personalisht dhe praktikisht për ta kërkuar ndihmën e autoriteteve në Kosovë
55. Më tej, ndonëse nuk i kushton rëndësi të madhe këtij fakti, Paneli thekson se ankuesi përmend ngritjen e çështjes së zhdukjes së familjarit të tij me një punonjës të EULEX-it, ndonëse data dhe vendi i saktë i atij takimi janë kryesisht të panjohura.
56. Për të vendosur nëse kishte ende gjasa të arsyeshme për një hetim në këtë rast, duhet të theksohet si më poshtë. Së pari, Misioni kishte në dispozicion të tij informacione që kishin të bënin me atë rast që të paktën duhej t'u kërkonte organeve të tij të shqyrtorin nëse do ta fillonin apo jo një hetim. Arsyeya pse ai duket se ka zgjedhur të mos e bëjë këtë vlerësim është e paqartë. Në këtë drejtim, mbase është menduar që pistat e mundshme të hetimit, në veçanti, intervistimi i të pranishmëve në kohën e zhdukjes; intervistimi i familjarëve të cilët mund të posedojnë informacione përkatëse; hetimi i rasteve të ngjashme në atë zonë në atë kohë; hetimi i autorëve të mundshëm ose njësive të njohura aktive në atë zonë në atë kohë, do të ishin shqyrtuar me qëllim të

përcaktimit të mundësisë dhe qëndrueshmërisë së hetimit. Nuk është e paarsyeshme të supozohet se, nëse janë shqyrtuar këto, mund të ishte marrë vendimi për ta filluar ose jo hetimin e plotë. Së dyti, siç u cek më sipër, hetimi dhe ndjekja penale e këtij lloji të çështjeve qëndronte në thelbin e përgjegjësive të Misionit për Sundimin e Ligjit dhe ky Mision me të vërtetë i ka hetuar një numër të këtyre rasteve disa dekada pas zhdukjes së viktimave. Mbi këtë bazë, nuk do të ishte e paarsyeshme të supozohej se ai mund ta kishte hetuar edhe këtë rast. Duke e ditur këtë, mund të duket naive sikur ankuesi do ta kishte vendosur besimin e tij në mundësinë e një hetimi nën mbikëqyrjen e EULEX-it për kaq shumë vite, por kjo pritshmëri nuk ishte e paarsyeshme në kuptimin e shqyrtimeve të përshkruara më sipër dhe në kuptimin e përgjegjësisë thelbësore të këtij Misioni në lidhje me këtë lloj rastesh. Për më tepër, siç theksohet nga GJEDNJ, nuk mund të mos jetë e paarsyeshme që një i afërm i një personi të zhdukur të presë për disa vjet "derisa shpresa e përparimit [që] po bëhet të jetë zhdukur në mënyrë efektive" (*Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, paragrafët 162-163; Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafët 50-51).

57. Më tej, duke parashtruar se nuk ka pasur perspektivë reale të një hetimi për këtë rast, Misioni nuk ka shpjeguar se përse është ajo dhe pse, në veçanti, nuk është bërë një vlerësim i asaj mundësi në kohën në bazë të materialit të marrë nga UNMIK-u dhe pse Misioni nuk i ka kontaktuar familjarët e të zhdukurit për të marrë informata para bërjes së atij vlerësimi.
58. Për më tepër, vonesa në paraqitjen e ankesës e pretenduar nga Misioni nuk duket se ka shkaktuar ndonjë paragjykim për sa i përket procedurave para Panelit. Shih Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafi 59. Interesi që Misioni mund ta ketë për zbatimin e rreptë të afatit 6-mujor gjithashtu duhet të interpretohet në këtë kuptim.
59. Prandaj, në kuptim të gjitha këtyre rrethanave, vonesa që i është ngarkuar ankuesit nuk mund të thuhet se është e tepërt ose e pashpjegueshme pasi ankuesi ka vazhduar të kërkojë dhe t'i kontaktojë ato autoritete për të cilat ai ka menduar se mund të ndihmonin për ta çuar këtë hetim përpara. Edhe sot e kësaj dite ekziston një interes i fuqishëm dhe detyruës që kjo çështje të hetohet në mënyrë të plotë dhe efektive.
60. Në këto rrethana, Paneli është i bindur që ankuesi i ka plotësuar kriteret e Rregullores dhe se ankesa e tij ishte paraqitur në kohën e duhur. Sidoqoftë, fakti që ka kaluar kaq shumë kohë nga zhdukja e familjarit të ankuesit mund të ndikojë në lehtësimin që Paneli mund ta jepte nëse ankesa të ketë sukses në meritat e saj.
61. Paneli thekson që, *ratione temporis*, ai është kompetent që t'i shqyrtojë veprimet e këtij Misioni deri më 14 qershor 2018. Pas kësaj date, Misioni nuk kishte ndonjë përgjegjësi ekzekutive në lidhje me këtë rast. Veprimet e kryera pas kësaj date mund të jenë relevante, megjithatë, për ta vlerësuar shkallën në të cilën mund të thuhet se ky Mision i ka përmbushur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Prandaj, Paneli fton Misionin që të ofrojë referenca në parashtrimet e veta për çfarëdo përpjekje të ndërmarrë nga ky

Mision për të siguruar që ky rast ishte apo është duke u hetuar (nëse po), përfshirë pas kësaj date.

*Të drejtat e tjera që pretendohet se janë shkelur nga Misioni*

62. Pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesa duhet të shpallet e pranueshme në lidhje me të drejtat e mbrojtura me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
63. Ankuesi po ashtu ka parashtruar se të drejtat e tij nga dispozitat si në vazhdim janë shkelur nga Misioni: a) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, nenet 1, 2, 3, 7 dhe 13; b) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 5 dhe 15; dhe c) Protokollit 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 2.
64. Përveç të drejtave të mbrojtura me nenin 13 të Konventës, Paneli nuk ka gjetur mbështetje faktike të mjaftueshme në dokumentet e paraqitura për të shpallur ankesën e pranueshme në lidhje me të drejtat e tjera të renditura. Në veçanti, Paneli nuk ka gjetur asnjë bazë në mbështetje të sugjerimit se ankuesi do të ishte diskriminuar nga Misioni në shkelje të Protokollit 12 të KEDNJ.

**PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**SHBALL TË PRANUESHME**, pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe

**SHBALL TË PAPANUESHME** ankesën për pjesët tjera;

**KËRKON NGA PALËT QË T'I ADRESOJNË PYETJET NË VIJIM:**

**i. Për Misionin:**

1. Çfarë hapi apo hapa ishin ndërmarrë nga Misioni apo ndonjë nga organet e tij për ta hetuar këtë rast, nëse ishte ndërmarrë ndonjë?
2. Në paragrafin 24 më lartë, ceket si në vijim: Një bazë e të dhënave që i ishte dorëzuar EULEX-it nga UNMIK-u tregon se me sa duket në vitin 2003 kësaj zhdukjeje i ishte caktuar një numër i rastit nga Njësia e Policisë së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur. Megjithatë, Misioni nuk ka marrë dokumente nga NJPZh në lidhje me këtë. A i ka kërkuar Misioni këto dokumente? Nëse po, kur dhe cila ishte përgjigjja e UNMIK-ut për atë kërkesë?
3. A i është komunikuar ndonjë dokument për këtë rast që është marrë nga UNMIK-u familjarëve të zhdukurit? Nëse nuk i është komunikuar, përse?

4. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas Neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?

ii. **Për ankuesin:**

1. Çfarë kontakti, nëse ka, keni pasur ju me Misionin EULEX Mision apo me përfaqësuesit e tij?
2. A jeni në dijeni për ndonjë përpjekje nga autoritetet vendase për ta hetuar këtë rast?
3. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas Neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
4. Cilat janë pasojat personale, financiare, ligjore dhe emocionale që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

**KËRKON** nga palët që t'i ofrojnë përgjigjet e tyre për pyetjet si më sipër jo më vonë se deri më 11 nëntor 2019.

Për Panelin:

Guénaél METTRAUX  
Kryesues



Anna BEDNAREK  
Anëtare

Anna AUTIO  
Anëtare